



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Godina ish-hotel "Drini" Tiranë

Tel/Fax: 04 2268141; 042268142

Nr. 661/4 Prot.

Tiranë, më 11.04.2017

V E N D I M
Nr. 80, datë 11.04.2017

"Për pezullimin e procesit të verifikimit nisur me
urdhrin nr.661 prot, datë 14.11.2016"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, të neneve 77 e vijues të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", dhe të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të kërkesës së ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave përmes shkresës nr. 7053 prot, datë 21.03.2017,

V ë r e j s e

Në zbatim të Urdhrit të Verifikimit nr. 661 prot., datë 14.11.2016, pas administrimit të informacionit që është dërguar pranë KMSHC nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ka filluar inspektimi për verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera nga ky institucion, gjatë procesit të transferim të përkohshëm në detyrë të disa nëpunësve civilë.

Pasi u shqyrtua paraprakisht përmbajtja e akteve të dëguara si mbështetje e problemeve të evidentuara në informacionin e përmendur më sipër, lindën dyshime të arsyeshme në lidhje me respektimin e afateve të transferimit të përkohshëm; mosrespektimin e kategorisë së pozicionit të punës dhe të pagës, gjatë procesit të transferimit të përkohshëm të disa nëpunësve civilë, e për këtë arsye filloi hetimi administrativ dhe më tej u njoftuan Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Departamenti i Administratës Publike për këtë proces. Në përputhje me përmbajtjen e neneve 87 dhe 88, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", gjatë inspektimit, ju kërkua institucionit nëpërmjet personit të caktuar për të mbajtur kontaktet me Komisionerin, që të jepte sqarime lidhur me veprimet administrative objekt i këtij hetimi, përpara marrjes së vendimi përfundimtar nga Komisioneri.

Në vijim të komunikimit me institucionin, me shkresën nr.7053, datë 21.03.2017, me lëndë “Kërkesë për shtyrje afati”, është kërkuar shtyrja e afatit të dërgimit të dokumentacionit të kërkuar nga Komisioneri.

Në këtë shkresë është argumentuar se, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 9, datë 11.01.2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave për personelin e administratës doganore”, është miratuar struktura e re për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe për këtë arsye, nga ana e Komisionit të Ristrukturimit, aktualisht po trajtohen rast pas rasti, të gjitha pozicionet të cilat preken nga ristrukturimi, duke analizuar përshkrimet e punës, vlerësimet e punës, përshtatja e punonjësve me pozicionet e reja të krijuara, etj.

Mbështetur në këto argumenta, nga ana e institucionit është kërkuar kohë për të vënë në dispozicion të Komisionerit, aktet e kërkuara në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të transferimeve të përkohshme në detyrë të disa nëpunësve civilë, duke e lidhur afatin me përfundimin e procesit të ristrukturimit.

Nga analiza e dokumentacionit i cili është vënë në dispozicion deri tani, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, si dhe nga përmbajtja e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.9, datë 11.01.2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave për personelin e administratës doganore”, Komisioneri, konstaton se ky institucion ndodhet në kushtet e ristrukturimit. Ky proces ka filluar me aktin nr. 30052/1 prot., datë 18.01.2017, përmes të cilit urdhërohet zbatimi i Vendimit të sipërcituar. Më tej, me urdhrin nr. 7, datë 19.01.2017, të Departamentit të Administratës Publike, është ngritur Komisioni i Ristrukturimit i cili ka filluar menjëherë nga puna.

Në këto rrethana, duke marrë parasysh nivelin e lartë të vështirësisë së procesit të ristrukturimit;

- ✓ **së pari**, për shkak të numrit të madh të pozicioneve të punës dhe punonjësve që preken nga ristrukturimi,
- ✓ **së dyti** për shkak të dokumentacionit voluminoz që e shoqëron procesin, i cili do të merret në shqyrtim nga Komisioni i Ristrukturimit
- ✓ **së treti**, për shkak të dokumentacionit voluminoz që do të krijohet gjatë procesit nga Komisioni i Ristrukturimit dhe më pas, në përfundim të procesit nga Njësia Përgjegjëse, pasi të gjitha ndryshimet gjatë procesit të ristrukturimit duhet të shoqërohen edhe me aktet administrative të cilat e materializojnë atë, ç`ka do të kërkojë një kohë relativisht të gjatë për ta përfunduar,

Komisioneri, e vlerëson të drejtë kërkesën Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për shtyrjen e afatit të dorëzimit të dokumentacionit.

Ndërkohë, sjellim në vëmendje të Njesisë Përgjegjëse të institucionit se gjatë këtij procesi, duhet t'i kushtohet një kujdes I veçantë zbatimit të nenit 50, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 17.02.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 921, datë 29.12.2014, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar,

norma të cilat përcaktojnë në mënyrë të detajuar modalitetet e aplikimit të institutit të transferimit të nëpunësve civilë, në procesin e ristrukturimit. Gjatë këtij procesi, për të gjithë nëpunësit të cilët e kanë përfunduar afatin e transferimit të përkohshëm, të vlerësohet mundësia për kthimin në pozicionet e tyre të punës.

Sa u analizua më sipër, vlerësoj se kërkesa e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për shtyrjen e afatit të dorëzimit të dokumentacionit është e justifikuar dhe në këtë rast Komisioneri vlerëson se duhet të pezullohet procesi i verifikimit të informacionit, deri në momentin e përfundimit të procesit të ristrukturimit të institucionit.

Për këto arsye:

Bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në nenin 66 të ligjit nr. 44/2014, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, dhe Rregullores “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të pezulloj procesin e verifikimit të informacionit të nisur me urdhrin e verifikimit nr. 661 prot., datë 14.11.2016, deri në momentin e përfundimit të procesit të ristrukturimit dhe nxjerrjes së akteve përfundimtare të transferimit, apo të përfundimit të marrëdhënieve me shërbimin civil, nga Njësia Përgjegjëse.
2. Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të njoftojë me shkrim Komisionerin, për përfundimin e procesit të ristrukturimit, si dhe të dërgojë të gjitha aktet e kërkuara për realizimin e këtij procesi verifikimi.
3. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA